

Fakulteti: Fakulteti i shkencave sociale

Lënda: Lojërat dhe lodrat, Profesori lendes, Mr. Emrush Xhemajli

Njësia: TEORITE PER LOJERAT DHE LODRAT.

Dijetarë, pedagogë, filozofë, sociologë, mjekë e psikologë njohur botëror në punën e vetë kërkimore i kanë kushtuar rëndësi edhe lojërave e lodrave femënore. Varësisht nga koha, klasa, pikëpamja e tyre janë zhvilluar disa teori lidhur me lojën, lojërat dhe lodrat femënore. Më poshtë po japim disa nga teoritë e njohura lidhur me lojërat dhe lodrat.

TEORITE BIOLOGJIKE LIDHUR ME LOJEN DHE LOJRAT

Teoria e Herber Spenserit. Sipas kësaj teorie **loja paraqitet si rrjedhim i energjisë së paharxhuar**, përkatesisht të energjisë tepruar. Spenseri organizmat i ndau në organizma të ulët dhe në ata të lartë.

Organizmat e ulët tërë energjinë e vete e harxhojnë për t'i plotësuar nevojat elementare jetësore. Kurse organizmat e zhvilluar në një shkallë më të lartë janë më të përsosur dhe ata për plotësimin e nevojave themelore jetësore nuk e harxhojnë tërë energjinë, d.m.th. tek këta organizma mbetet një sasi e pashfrytësuar (e pa harxhuar) e energjisë, tepriçë e saj. Siaps kësaj teorie tepriça e saj është burim dhe nxitës i aktiviteteve të llojllojshme të fëmijës, të cilët vijnë në shprehje gjatë lojës së tij.

Teoria e Stenli Hollit (A.S. Hall) lojën e fëmijës e shpjegoi në bazë të ligjshmërive biologjike, sipas të cilave **çdo vogëlush i kafshëve në rrugën e tij zhvillimore**

ikapërcen të gjitha format e zhvillimit nëpër të cilat ka kaluar paraardhësi i tij. Sipas kësaj teorie, loja e fëmijës është lëvizja e atyre formave, të cilat i ka kapërcyer dhe përjetuar njerëzia. Teoritë BIOLOGJIKE janë plotësisht në kundërshtim me karakteristikat të cilat hasim në lojërat e fëmijëve. Kuptohet, përmbajtja dhe mënyra e lojës varet nga edukata dhe nga kushtet ambientale, në të varet nga edukata dhe nga kushtet ambientale në të cilat jeton, fëmija. Kjo teori e asgjëson dhe përjashton rëndësinë e rrethit shoëror si factor.

Teoria e Karl Grosit: është ndër teoritë më të zhvilluara mbi lojën e fëmijës. Per Grosin **loja e fëmijës është shkollë përgatitore e qenjes jetësore për jetën e ardhme.** Tek qeniet e gjalla, që i takojnë shkallës më të ulët zhvillimore, pjekuria arrihet për një kohë më të shkurtër, kurse tek qënjet që i përkasin shkallës më të lartë zhvillimore pjekuria e tyre zgjatë një kohë më të gjatë.

Sipas Grosit tek gjinia njerëzore **“shkolla përgatitore”** është shkollë e fëmijërisë që zgjatë ekskluzivisht më gjatë. Qëllimi kryesor i kësaj shkolle është përgatitja e fëmijës për të gjitha ato, të cilat atë e presin në jetën e tyre. Fëmija në periodën fëmijërore fiton përvojë, i zhvillon aftësitë e veta, i formon shprehitë dhe të gjitha ato që atij i nevojiten për jetë. Mirëpo, për Grosin, **“Shkolla përgatitore kërkon mjete dhe kohë. Koha e duhur është fëmijëria dhe rinia, kurse loja është mjet. Loja duhet të jetë mjet i cili e mundëson që të paraqiten dhe përsosen insiktet e lindura, të cilat më vonë ia mundësojnë qenjes jetësore (fëmijës) që me sukses të gjendet dhe përshtatet në luftën për ekzistencë”**.

Sipas kësaj teorie, të gjitha ligjshmëritë që vlejné për jetën e kafshëve, automatikisht vlejné edhe për njeriun. Grosi as e ka pasur parasyshtë se njeriu është përveç qenie biologjike edhe qenie sociale e psikologjike. Ai theksoi se fëmija nuk loz për arsye se është fëmijë dhe i ri, por fëmijës i është dhënë fëmijëria dhe rinia për të luajtur.

Teoria e Carrit. Per tejkalimin e teorisë biologjike mbi lojën e fëmijës bëri përpjekje Carri i cili theksoi se **loja e ka rolin kryesor në eliminimin e prirjeve dhe instikteve të pafisnikëruara.** Sips tij loja është mjet me anën e të cilës natyra

shtazarake e fëmijës zbutet dhe fisnikërohet. Kuprohet, me këto botëkuptime assesi nuk mund të shpjegohet esenca e lojës së fëmijës. Kjo teori shpjegon se si nëse fëmija luan me kukulla do t'i dobësojë njetat amtare. Megjithatë, përvoja e vërteton të kundërtën.

Viljem Shtereni (VV.Shtern), psikolog gjerman, theksoi rëndësinë e trefisht të lojës:

- **Në aspektin e të së kaluarës** (sipas teorisë biogjenetike);
- **Në aspektin e të sotmës** (kur bëhet fjalë për veprimin e më tepër të epsheve të fëmijëve)
- **në aspektin e ardhmërisë** (teoria e Grosit)

Shterni nuk arriti sukses për t'i mënjeluar të metat e teorive të përparshme. Megjithatë, shikimet e tij ndaj lojës patën edhe disa anë pozitive. Merita kryesore e Shternit është theksimi i tij se:

- **elementet përbërëse të lojës janë spontaniteti dhe liria.**

TEORIA FUNKSIONALE E LOJES

Sharlota dhe Karl Billeri (Billar). – bënë përpjekje për të dhënë kontribut në shndritjen e problemit rreth origjinës dhe esencës së lojës së fëmijës. Per të dy këta psikologë, **loja ka rol primar në formimin e funksioneve, kurse motori i vërtetë që e nxit fëmijën për të zhvilluar aktivitete të palodhshme gjatë lojës është në të vërtetë GËZIMI FUNKSIONAL**, të cilin fëmija e përjeton gjatë aktivitetit të tij në lojë. Kjo teori i dha primat anës funksionale. Fëmija në lojë shpeshherë përjeton edhe dëshprim, megjithatë ai përsëri vazhdon të luajë. Pra, kënaqësia funksionale edhe gëzimi nuk janë të vetmit burim të aktivitetit të fëmijës gjatë lojës. Gjithashtu, duhet theksuar se formimi i funksioneve s'është e vetmja dobi e lojës.

KENDVESHTRIM FILOZOFIK PER LOJEN FEMINORE

Fridrih Shiler, poet e filozof gjerman. Ai ndër të parët bëri përpjekje për ta shpjeguar lojën e fëmijës nga aspekti filozofik. Sipas tij në organizimin e njeriut vepron dy fuqi:

- a. Fuqia që vepron në drejtim të plotësimit të kushteve themelore të domosdoshme për jetë; dhe**
- b. Fuqia e cila e përsos organizimin e njeriut dhe e cila atë e ngrit mbi nevojat primitive.**

Sipas kësaj teorie PUNA ka të bëjë me fuqinë e parë, kurse loja, me fuqinë e dytë.

Mendimet e Shilerit nuk janë të provueshme. Loja për fëmijë s'është diç polotësuese, rekreative e as diç jashte aktiviteteve themelore të fëmijës. Lojën e hasim në forma të ndryshme edhe atë në të gjitha aktivitetet e fëmijës.

TEORITE PSIKOANALITIKE

FROJDI, ADLERI DHE JYNGI: Nën ndikimin e këtyre studjuesve paraqitet një numër i madh teorive psikoanalitike mbi vlerën diagnostike dhe terapeutike të lojës së fëmijëve.

Përfaqësuesit e kësaj teorie lojës së fëmijës i dhanë rëndësi simbolike, kurse sjelljen e fëmijës gjatë lojës e shpjeguan në mënyrë simbolike. Siaps Frojdit në lojë janë të shtypura tendencat seksuale, kure Adlerit, pohoi se loja i shtyp (ndrydh) ndjenjën e kompleksit të infoerioritetit dhe fëmijës ia mundëson për ta njohtuar forcën dhe fuqishmërinë e vet. Këto teori janë të papranueshme, sepse të gjitha aktivitetet e fëmijëve gjatë lojës kanë rëndësi simbolike. Megjithatë, është e vërtetë se loja mund të shfrytëzohet edhe si mjet diagnostik dhe terapeutik.

TEORITE KOGNJITIVE¹

Teoritë kognjitive theksojnë rëndësinë dhe rolin për zhvillimin e vetëdijës dhe të sferës emocionale të personalitetit të fëmijës. Këto teori, lojën e fëmijës e shikojnë si aktivitet specifik të njohjes i cili ka rëndësi tejet të madhe për zhvillimin e funksioneve simbolike.

ZH. Piezhe teorinë e vet mbi lojën e fëmijës e ndërtoi duke punuar dhe duke u marrë me zhvillimin e të menduarit logjik, përkatësisht duke u marr me stadin e zhvillimit të botëkuptimit të fëmijës.

Sipas tij loja është rrjedhim i zhvillimit të pamjaftueshëm të mënyrës së të menduarit të fëmijës. Sipas Piezhesë, ushtrimi, simboli dhe rregullat janë tri etapat, me të cilat karakterizohet numër i madh i lojërave dhe aspekti i strukturës intelektuale të fëmijës. Sipas tij loja simbolike është përpunimi i fotografive mentale, të formuluar nëpërmjet rrugës së asimilimit, e cila nuk e merr parasyshë realitetin. Origjina e fotografive mentale qëndron në imitim, që transformohet në fotografi mentale nëpërmjet rrugës së interiorizmit (mbrendshme). Këto fotografi mentale kanë vlerë intime dhe emotive e që janë të lidhura me fakte shqisore (dituri shqisore). Per këtë arsye loja simbolike është aktivitet në të cilin realiteti është i përpunuar në harmoni me nevojat e fëmijës.

Mësimet e Piezhesë mbi lojën e fëmijës janë kritikuar me të madhe duke i quajtur edhe mendime kontrakitore mbi lojën.

VIGOTSKI, ELKONJINI DHE LEONTJEVI. Edhe këta studjues janë përfaqësues të teorisë kognjitive.

Per Vigotskin vendin primar e ka loja simbolike dhe loja me role.

TEORITË FENOMENOLOGJIKE DHE STRUKTURALISTE MBI LOJËN E FËMIJËS

¹ Zhvillimi kognjitiv: Leme e zhvillimit te personalitetit të njeriut ku bëjnë pjesë: dituritë, botëkuptimet, aplikimi, analiza, sinteza, vlerësimi... Në këtë rast kjo teori i jep rëndësi kësaj lëmie ndërsa të dorës së dytë konsiderojnë lëmin afektiv dhe psikomotorik të zhvillimit të personalitetit.

Këto teori theksojnë qëndrimin ekzistencial të lojtarit me ambientin në të cilin luhet (lozet) dhe të cilit i takon mënyra sipas së cilës ky qëndrim realizohet.

F. Bojtendajk. Sipas tij **loja është shprehje e epsheve për lirim, bashkim dhe përsëritje.** Loja s'është trajnim "por rrugë" për edukimin e formave të reja të sjelljes, si të domosdoshme për të marrë pjesë në të gjitha kushtet e ndërlikuara jetësore.

Zhan Shato. Ai lojën e shikon is shprehje të nevojave të fëmijës për aktivitet. Fëmija i pakënaqur me rolin e vet, ai dëshiron që të bëjë diç konkretisht, të bëhet njëfar "kandidati" dhe në këtë mënyrë të shprehet dhe vërtetohet, d.m.th. t'iu ofrohet të rriturve.

Brajan Saton Smith. Ai lojën e trajtoi si komunikim, në të cilin mund të shënohen disa struktura pavarësisht nga përmbajtja. Smithi lojën e definoi në aspektin e sjelljes adaptive, duke konsideruar si formë për gjurmim të variacioneve njohëse. Sipas tij loja ia mundëson fëmijës për të fituar përvojë sociale, nëpërmjet sjelljeve të cilat nuk do të pranoheshin në jetën reale. Për këtë arsye loja përkufizohet edhe si mësim (të mësuarit) i vullnetshëm social.

Përfundim:

Nga të gjitha teoritë dhe shkrime e cekura deri më tani mund të përfundojmë se për origjinën, esencën dhe rolin e lojës së fëmijës nuk mund ta shpjegojmë vetëm me anën e të së vetmes teori. Akoma **nuk ekziston një teori përfundimtare** dhe e pranuar përgjithësisht. Kryesisht origjina dhe burimi i lojës duhet te kerkohet në vetë jetën e fëmijës, në natyrën e tij psikike, e cila është zhvilluar në shoqëri njerëzore.

Megjithatë krahas dallimeve, gati të gjithë përfaësuesit e teorive të cekura mbi lojën e fëmijëve janë të një mendimi për këto fakte:

- Loja është **burim i gëzimit** dhe ajo i pergjigjet natyrës së fëmijës;
- Loja e **zgjon dhe i zhvillon të gjitha aftësitë fizike dhe psikike** të fëmijës;
- Me anën e lojës fëmija **njihet me ambientin e tij dhe aftësohet për të marrë pjesë aktivisht në të;**
- Loja **fëmijën e fut në botën e moshatarëve të tij** dhe në atë shoqëri fëmija e gjen vetëveten, vlerën dhe vendin e tij në grupmoshën e fëmijëve.
- Me anën e lojës lirisht dhe natyrshëm **formohet personaliteti I fëmijës;**
- Me anën e lojës fëmija e **formon qëndrimin e drejtë ndaj rrethit të vet dhe formon karakterin** e tij...